



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije / Ministry of Economy

Për:	Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Drenasit Burim Bujupi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Drenas Erblin Hetemi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor MAPL
Kopje:	Elbert Krasniqi, Ministër në MAPL Jeton Qela Sekretar i Përgjithshëm në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve/MAPL
Përmes:	Artane Rizvanolli, Ministre e Ekonomisë <i>p.p. ÇMIFEKU</i> Leonita Shabani Mullarama, Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Ekonomisë
Nga:	Deniza Krasniqi, Ud. Drejtoreshë e Departamentit Ligjor/ME <i>D. Mashiti</i> Datë: 28.04.2026
Zyrtarët përgjegjës: 1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2.Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Dëfrim Pllashniku, Udhëheqës i Divizionit për Politika të NP/NJPMNP Arbërore Bërnica-Hasani, Analiste ligjore/NJPMNP <i>Bee</i>
Lënda:	Shqyrtim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Drenasit
Lloji i aktit:	Vendimi 02 Nr.020/04-11325 i Kuvendit të Komunës së Drenasit

I nderuar Kryetar z. Lladrovci,
I nderuar Kryesues z. Bujupi,

Ministria e Ekonomisë ka pranuar kërkesën nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal me Nr. prot. 570 datë 02.04.2026, për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit komunal të Komunës së Drenasit, Vendimin 02 Nr.020/04-11325 për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "Eko-Drenasi" Sh.A., të miratuar më datë 30.03.2026 nga Kuvendi Komunal i Drenasit.

Bazuar në nenin 9, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregullore (QRK) Nr. 03/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave si dhe bazuar në legjislacionin përkatës për Ndërmarrje Publike, Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike (NJPMNP) në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, vlerëson se Vendimi 02 Nr.020/04-11325 për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të

Ndërmarrjes Publike Lokale "Eko-Drenas" Sh.A., me kompetencë për të vepruar në emër të komunës përkatëse është në përputhje me nenin 5.2 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Arsyetim

Neni 5 paragrafi 5.2. i Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike përcakton se: "Kur një komunë është aksionare në një Ndërmarrje Publike Lokale, të drejtat e saj të aksionarit ushtrohen nga një Komision Komunal i Aksionarëve, i cili përbëhet nga (i) një anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe (ii) dy anëtarë të tjerë të emëruar nga Kuvendi Komunal. Për këtë qëllim, Komisioni Komunal i Aksionarëve ka të drejtë të veprojë në emër të komunës përkatëse dhe duhet të veprojë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Çdo Komision Komunal i Aksionarëve duhet, me shumicë të thjeshtë votash, të vendosë se si do t'i ushtrojë të drejtat e aksionarit të komunës në një çështje të caktuar."



Mbi këtë bazë, Vendimi i Komunës së Drenasit që përcakton përbërjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale, me kompetencë për të vepruar në emër të komunës përkatëse, është në harmoni me legjislacionin në fuqi për ndërmarrjet publike.

Ministria e Ekonomisë mbetet në dispozicion të Komunës dhe MAPL-së për çdo sqarim të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt,

*** Vlerësimi i dhënë nga Ministria e Ekonomisë përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin e Ministrisë së Ekonomisë si sponsorizuese e legjislacionit për Ndërmarrjet Publike***





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
 Ministry of Local Government Administration

Për:	Leonita Shabani Mullarama, Sekretare e Përgjithshme në Ministrinë e Ekonomisë	
Kopje:	Kryetar i Komunës së Glllogocit Kryesuesi i KK - Glllogoc Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Erbllin Hetemi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor	Data: 31.03.2026 VI-020-236
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari përgjegjës Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Aktiveve të Kryetarit 2. Zyrtari përgjegjës Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Aktiveve të Komunës	
Lënda:	Shkresë përcjellëse në ME	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar Vendimin 02Nr.020/04-11325 për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për NPL "EKO - Drenasi" Sh. A - Glllogoc, i miratuar në Kuvendin e Komunës së Glllogocit dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Glllogocit, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Aktiveve të Komunave, dhe në nenet 7 dhe 9 të Rregullores (QRK) Nr.03/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendimin 02Nr.020/04-11325 për formimin e komisionit komunal të aksionarëve për NPL "EKO - Drenasi" Sh. A - Glllogoc

I miratuar më datë: 30.03.2026

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 31.03.2026



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Gllgoc)
Kuvendi i Komunës

02 Nr. 02/16/11325dt. 30/03/2026

Ministria e Administrimit të Përbashkët Lokal Ministry of Local Government Administration		
Data: 30.03.2026		
Lloji i Dokumentit: 02/16/11325dt. 30/03/2026		
-1- 028-236		



Bazuar në nenin 11, 12 dhe 40 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe nenin 34, të Statutit të Komunës së Gllgocit, të datës 16.09.2008, në përputhje me nenin 5.2, të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111 dhe Ligjin nr. 05/L-009, si dhe në zbatim të pikës 3 të Vendimit të Qeverisë për themelimin e ndërmarrjes publike NPL "EKO Drenasi", me nr. 10/02, të datës 20.02.2026. Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 30.03.2026 miratoi këtë:

VENDIM

Për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për NPL "EKO - Drenasi" Sh. A - Gllgoc

I. Me këtë vendim formohet Komisioni Komunal i Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale "EKO Drenasi" Sh. A në Drenas, në përbërje:

I.I Kuvendi i Komunës dy anëtarë: 1. Khavit Drenari
2. Driton Ajzi

I.II Ekzekutivi i Komunës një anëtar: 1. Laureta Thaçi

II. Komisioni Komunal i Aksionarëve nga pika I e këtij vendimi obligohet të ushtroj të drejtat e aksionarit në përputhje me Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrje publike, Ligjin nr. 04/L-111 për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrje publike, Ligjin nr. 03/L-87 dhe Ligjin nr. 06/L-16 për shoqëritë tregtare.

III. Mandati i anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve të NPL-së përfundon me përfundimin e mandatit aktual të anëtarëve të Kuvendit të Komunës apo me adonjë vendim tjetër të Kuvendit të Komunës.

IV. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueh faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:

- Zyres së Kryetarit ;
- Drejtoriat Përkatëse;
- Zyres së Kuvendit;
- Arkivit



Kryetari i Kuvendit Komunal

Barim Bajupi